

Më
Data

27. 07. 2017

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të akuzuarit, [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kryen veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nenpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.433-5/2015 të datës 20.05.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.05.2017, ne praninë e prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani dhe të akuzuarit shpall dhe publikisht komunikon këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari, [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], i lindur me dt. [REDAKTUAR] ne të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE

Gjatë muajit dhjetor të vitit 2014 në fshatin Cernillë përkatësisht në shtëpin pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] në bashkëkryerje, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

██████ kanë depërtuar përmes derës së korridorit në shtëpi dhe me përdorimin e forcës me kacavide dhe pajser kanë thyer derën dhe nga aty kanë marrë një kamerë digjitale te tipit "Maginon 5 megapixel", një telefon "Motorola" dhe një aparat për rroje, duke i shkaktuar dëm të dëmtuarit.

-me të cilën ka kryer veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nenpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Ne bazë të dispozitës së lartshënuar dhe dispozitave nga neni 3,6,11,16, 34,38 39,64, 66 e 67 të KPK-së, si dhe neni 365 të KPPK-se të akuzuarin e,

G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1/nje /viti/**, në dënimin e shqiptuar do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.01.04.2015 deri më 30.04.2015 dhe dënim me gjobë në lartësi prej **300 /treqind/ €**, ekzekutimi i të cilit do të bëhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 3 të KPK-së, në të kundërtën do të zëvendësohet në dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuaj 1/një/ditë burgu.

I dëmtuari, ████████ dhe ████████ nga fshati ████████ komuna ████████ për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej prej 30/tridhjetë /€ në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.433-5/2015 të datës 20.05.2015, e ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale ne bashkëkryerje me te akuzuarin [REDAKTUAR] kryen veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nenpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze mbajti shqyrtimin Fillestar me datë 24.05.2017 në të cilën përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit, Ismet Rrahmani pas marrjes së te dhënave te te pandehurit [REDAKTUAR] ku u vërtetua fakti se i njëjti ne kohen e kryerjes së veprës penale ka qene person i mitur, andaj gjykata ka ndar procedurën dhe për te njëjtin lënda procedohet në departamentin për të mitur.

Prokurori i shtetit beri rikualifikim e veprës penale nga ne bashkryerje kryen veprën penale vjedhje e rend nga neni 327 par. Nen par 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se ne kreu veprën penale vjedhje e rend nga neni 327 par.1 nene par.1.1 te KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj. Gjyqtari pasi u bind se i akuzuari e ka kuptuar akuzën konform nenit 248 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, i premtion gjykatës qe ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme penale, i ka propozuar gjykatës qe ti shqiptoj një dënim sa me te butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq janë leximi i deklaratës së të pandehurve të dhënë në polici , deklarata e të dëmtuarve, fotografitë të cilat gjenden ne shkresat e lendes, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm

të sendeve të dt.31.03.2015 dhe vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara i datës 01.04.2015.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nenpar.1.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, dhe nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Gjykata në kuptim të nenit 73, 75 dhe 76 të KPRK-s bëri zbutjen e dënimit duke çmuar rrethanat veçanërisht lehtësuese, gjykata bëri zbutjen e dënimit nënë kufijtë e paraparë të minimumit ligjor nga 3/tri /vite, në 1/nje / vite burgim duke i marr parasysh edhe pendimin e të akuzuarit për këtë vepër penale, duke shprehur keqardhje, është hera e

parë që bie ndesh me ligjin, i gjendejes ekonomike, sjelljen korrekte gjatë gjithë procedurës po ashtu edhe në shqyrtimin fillestar, ndërsa rrethana renduese Gjykata nuk gjeti, mbi bazën e këtyre rrethanave, vlerësoj shkallen e rrezikshmërisë dhe peshën e kësaj veprë penale, duke qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv me bindjen se një dënim i tillë është adekuat dhe proporcional në raport me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe me të njëkohësisht arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale.

Konformë nenit 458, 459 dhe 460 të KPPK-së, pasi që nuk është specifikuar lartësia e dëmit nga ana e të dëmtuarve, gjykata të dëmtuarit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, i udhëzon në kontest civil.

Konformë nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjetë/ € në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitë këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.648/15 me datë 24.05 .2017

Zyrtarja Ligjore

Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale,

Hakile ILAZI

Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.